

KNF - WB WiB Faza II - NLB Prishtina

Shteti:	KOSOVË
Projekti Nr.:	54057
Spektori i biznesit:	Kredi depozitare (banka)
Lloji i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	FI
Data e Synuar e	
Aprovimit:	29 nëntor 2022
Statusi:	Aprovuar
DPP i shpalosur:	29 nëntor 2022

Përshkrimi i projektit

Hua e pasiguruar deri në 3 milionë euro që do t'i ofrohet NLB Prishtina në një kësht të vetëm për kreditim të mëtutjeshëm për NMVM të udhëhequra nga gratë të pranueshme në kuadër të Programit Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor Faza II ("WB WiB II").

Objektivat e Projektit

Të ardhurat do të përdoren për të financuar NMVM të udhëhequra nga gratë të pranueshme në pajtim me Deklaratën e Politikës të WB WiBP II.

Ndikimi i Tranzicionit

ETI 68

Projekti kontribuon në objektivat e Fazës II të WB WiB, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit të Tranzicionit si **Gjithëpërfshirës** dhe **Konkurrues**:

Gjithëpërfshirës: Projekti do të kontribuojë në përfshirjen ekonomike të grave duke mbështetur qasjen në financa dhe shërbime këshillimore për biznesin për NMVM-të e udhëhequra nga gratë, dhe synon të mbështesë zbutjen e hendekëve ekzistues gjinorë në nivel vendi në qasjen në financa duke demonstruar arsyet afariste për rritje të kreditimit për segmentin e NMVM-ve të udhëhequra nga gratë.

Konkurrues: Projekti do të kontribuojë drejt konkurrueshmërisë së sektorit financiar duke siguruar një rritje të qëndrueshme të portofolit të NLBP-së për NMVM-të e udhëhequra nga gratë, me fokus në tërheqjen e klientëve të rinj, depërtimin në zonat rajonale, dhe procedurat e kujdesshme të sigurimit.

Informata për Klientin

NLB PRISHTINA SH.A.

NLB Banka sh.a. ("NLB Prishtina", "NLBP") është banka e dytë më e madhe në treg, duke mbajtur një pjesë të tregut prej 17% në totalin e aseteve në fund të vitit 2021. Përmes rrjetit të saj me 34 degë/nëndegë dhe 463 punëtorë, NLBP u shërben më shumë se 347,000 klientëve në mbarë Kosovën.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

3,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

3,000,000.00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014). NLBP është klient ekzistues dhe performanca e saj deri më sot për ekspozimet ekzistuese në linjën e PLT-së, ka qenë e kënaqshme. NLBP do të hyjë në linja të tjera (WiB dhe NVM) të cilat do të kërkojnë vlerësim më të gjerë të zbatimit të Kërkesës së Performancës 9 së BERZH-it (KP9). Kjo do të përfshijë zbatimin e Procedurave të BERZH-it për Menaxhim të Riskut MS për Huatë për Korporata, NVM dhe Mikro, duke përfshirë respektimin e Listës së zgjeruar të BERZH-it për Përrjashtimet për MS dhe Listës së Referimeve të prezantuar me PMS 2019, si dhe dorëzimin në Bankë të raporteve vjetore për MS. Nën-huamarrësve të financuar nëpërmjet huasë për NLBP-në do t'u kërkohej të jenë në pajtueshmëri me kërkesat kombëtare të mjedisit, shëndetit, sigurisë dhe punës (MSHSP). NLBP-së do t'i kërkohej të harmonizojë procedurat ekzistuese me kërkesat e BERZH-it për MS dhe të emërojë një person nga menaxhmenti i lartë që të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e tyre. NLBP do t'i sigurojë DMQ-së emrat e stafit relevant të vlerësimit të riskut të kredisë, të cilët do të kenë qasje në programin e trajnimit online të BERZH për menaxhimin e riskut MS. Këto kërkesa do të jenë pakte në marrëveshjen e huasë. Përdorimi nga Projekti i të ardhurave ose shumëfishit të alokuar mund të përfshijë nën-projekte solare. Nën-projekte të tilla do të menaxhohen në përputhje me 'Qasjen e Propozuar të Menaxhimit për Menaxhimin e Riskut të Zinxhirit të Furnizimit Solar' (CS/FO/21-35) dhe çdo udhëzues pasues të zhvilluar sipas kësaj qasjeje.

Bashkëpunimi Teknik

BT: Grantet do të përdoren për të mbuluar mbështetjen këshillimore të NLBP-së për ndërtim të kapaciteteve dhe Këshillim për Biznesin e Vogël ("ASB") për NMVM të udhëhequra nga gratë. Fondet për BT ofrohen nga Qeveria e Suedisë.

Jo BT: Ndarja e riskut në formën e Mbulimit të Riskut të Humbjes së Parë ("MRHP") deri në 10% të Huasë WIB, me tavan prej 70% për çdo nën-hua të vetme. Fondet jo-BT për MRHP sigurohen nga Fondi i Posaçëm i Aksionarëve të BERZH-it.

Shtesë

Shtesa arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë në formën e një huaje senior, përmes një qasjeje holistike që përfshin grante jo-BT për t'i siguruar stimuj NLBP-së për ta eksploruar më tej segmentin e pazhvilluar të grave në biznes në formën e granteve për Mbulim të Riskut të Humbjes së Parë (MRHP) dhe BT për të mbështetur institucionet financiare partnere dhe NMVM-të e udhëhequra nga gratë.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Gem Maloku

Gem.Maloku@nlb-kos.com

+383 (0)38 744 005

+383 (0)38 744 005

www.nlb-kos.com

Rr. Ukshin Hoti nr. 124, KS-10000 Prishtinë, Kosovë

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e "zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor". PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar

zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt. OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikën e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikën mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.